



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

VENDIM

Nr. 14, Datë 28.10.2020

**PËR EMËRIMIN E NDIHMËSAVE PËR AUDITËT TEKNICIENË PËR
MBIKËQYRJEN E PROCESIT TË HARTIMIT TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE, PËR
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 19 pika 1 germa “n” dhe pika 2, neni 61 pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 2, datë 28.12.2012 “Për Miratimin e rregullave të veçanta për kushtet e kontratës dhe kryerjen e auditimit nga auditët teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave RKGjC, pasi shqyrtoi propozimet për ndihmësat për auditët teknicienë dhe dokumentacionin e paraqitur;

V Ë R E N

Referuar nenit 61, pika 1, pika 2 dhe pika 3 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbikëqyr procesin e hartimit të listave duke i kërkuar informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile. Jo më vonë se 30 ditë nga data e dekretimit të zgjedhjeve për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve emëron me vendim dy auditë teknicienë për verifikimin e veprimeve në bazën e të dhënave në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile. Të drejtën për të caktuar auditët teknicienë e kanë respektivisht Komisioneri dhe Nënkomisioneri.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve me vendimin 13, datë 28.10.2020 ka emëruar auditin teknicien për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, zj. Brisela Mehmetllari të caktuar nga Komisioneri.

Referuar nenit 61 pika 3 të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, auditët teknicienë ndihmohen nga jo më shumë se 2 ndihmësa, të cilët caktohen nga KQZ-ja me propozimin e auditit.

Ndihmësat për auditët teknicienë duhet të plotësojnë kushtet e mëposhtme:

- a) Të kenë arsim universitar dhe eksperiencë në fushën e zgjedhjeve;
- b) Të ketë njohuri në fushën e teknologjisë së informacionit apo statistikës, si dhe në procesin e hartimit të listave të zgjedhësve dhe/ose gjendjes civile;
- c) Të jenë të padënuar penalisht, së bashku me jetëshkrimet e tyre.

Nr. 14 i vendimit

Data 28.10.2020 e vendimit

Për emërimin e ndihmësve për auditët teknicienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.



Referuar nenit 61 pika 2 dhe pika 3 të Kodit Zgjedhor, auditi teknikien zj. Brisela Mehmetllari ka caktuar si ndihmës auditë teknikienë z. Krenar Fortuzi dhe Kevi Kamberi.

Kohëzgjatja e kontratës së z. Krenar Fortuzi dhe z. Kevin Kamberi me KQZ-në, do të jetë nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar, 30 ditë përpara ditës së zgjedhjeve. Duke pasur parasysh ngarkesën e punës dhe kohëzgjatjen e kontratës duhet të shpërblehen me 60 mijë lekë secili për të gjithë kohën e angazhimit të tyre.

PËR KËTO ARSYE:


Bazuar në nenin 19, pika 1 germa “n” dhe pika 2, dhe nenit 61 pika 3 të Ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S A:

- 1- Të emëroj ndihmësat e auditit teknikienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, z. Krenar Fortuzi dhe z. Kevin Kamberi.
- 2- Të caktojë masën e shpërblimit në vlerën 60 mijë lekë për ndihmës auditët teknikienë për gjithë periudhën, nga momenti i emërimit deri në dorëzimin e raportit përfundimtar.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- 4- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Ilirjan CELIBASHI



Nr . 14 i vendimit

Data 28.10.2020 e vendimit

Për emërimin e ndihmësave për auditët teknikienë për mbikëqyrjen e hartimit të listës së zgjedhësve, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.